

Pse duhet mbulesa e fytyrës/maska aty ku distancimi fizik nuk është i mundur/ambiente të mbyllura?



Maska/mbulesa e fytyrës është në gjendje të pengojë këtë skenar – duke ju ndihmuar të mbroni veten dhe të tjerët!



~7 metra

Reja gazore e një të teshtiture mund të 'udhëtojë' deri në 7 metra! Emetime të tjera të frymë-nxjerrjes mund të përshkojnë distanca të ndryshme. Reja gazore e një të kollituri mesatar mund të 'udhëtojë' deri në **6 metra** dhe avujt e frymënxjerrjes mund të shkojnë deri në **2 metra**. Të gjitha këto gjetje janë bazuar në hulumtim të **MIT**.


Për momentin nuk ekziston konsensus i plotë për një sistem rigoroz të ndarjes së spërklave dhe aerozoleve (=spërkla me madhësi grimcore shumë të vogël). Aktualisht po punohet me një sistem ku spërklat ndahen në 3 grupe:

Spërkla të mëdha: 100 mikron (diametër) ose më të mëdha



Këto spërkla janë relativisht më të rënda se të tjerat dhe vien në tokë brenda pak sekondave

Spërkla të vogla dhe aerozole të mëdha: 100 mikron ose më të vogla në diametër



Këto spërkla mund të qëndrojnë pezull në ajër për 30 minuta ose më shumë

Aerozole të vogla: 3 mikron ose më pak



Mund të qëndrojnë pezull në ajër për orë të tëra